



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 26. 10. 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Rexhepi – kryetar, Danush Ademi, Ibrahim Makolli,
Hajredin Hyseni, Luljeta Shehu, Shpresa Murati dhe Drita Maliqi.

Mungoi: Ibrahim Selmanaj.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi - OSBE, Nexhat Shatri – ZPK dhe Xhemajl Ahemti-OHCHR.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e drejtoi: Fatmir Rexhepi - kryetar.

Fatmir Rexhepi konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19. 10. 2010,
3. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
4. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
5. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri, nga aspekti i të drejtave të njeriut,

6. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për metrologjinë,
7. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme,
8. Të ndryshme.

Miratimi i rendit të ditës

1. *Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19. 10. 2010

Komisioni e miratoi pa vërejte procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 19. 10. 2010.

3. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligj

Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, nga aspekti i të drejtave të njeriut, (4) Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike, nga aspekti i të drejtave të njeriut, (5) Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri, nga aspekti i të drejtave të njeriut, (6) Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për metrologjinë, (7) Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, nga aspekti i të drejtave të njeriut, janë në pajtueshmëri me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut, Konventën për eliminimin të gjitha formave të diskriminimit dhe nuk i cenojnë parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, prandaj mund të procedohen për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

8 Të ndryshme.

Kryetari - Ju njoftoj se kemi pasur një takim me kryesuesen e grupit punues për Ligjin për persona të zhdukur dhe me kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, bashkë me përfaqësues të ICO - së, të OSBE - së, përfaqësues të zyrës amerikane dhe se ishte një takim më shumë i karakterit informativ. Po ashtu edhe grupi i punës e ka pasur një mbledhje dhe se puna rreth këtij projektligji besoj se do të vazhdojë ashtu si e kemi paraparë dinamikën me herët.

Ai gjithashtu tha se në emër të Komisionit janë bërë edhe rekomandimet, të cilat i janë përcjellë sindikalistëve të punës dhe invalidëve, kështu që kemi përmbushur kërkesat që duhet të ndërmerren. Po ashtu ju kemi drejtuar edhe kuvendit që duhet të mbahet një debat kur të shihet e arsyeshme për këtë çështje.

Ibrahim Makolli - Tha se në javën e kaluar është takuar me eurodeputeten znj. Tara Fajon. Pastaj shtoi se e ka njoftuar me punën që bëhet në këtë komision për harmonizimin e ligjeve me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Drita Maliqi- Pyeti: a mund të na njoftoni me punën apo ecurinë që po bëhet në grupin punues lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për personat e zhdukur? A janë harmonizuar rekomandimet nga dëgjimi publik?

Nerxhivane Dauti - E njoftoi Komisionin me punën që e ka zhvilluar grupi punës lidhur me Projektligjin për personat e zhdukur. Ajo i ka dëgjuar të gjitha vërejtjet e subjekteve relevante. Projektligji ka mangësi dhe ra dakord që vërejtjet t'i sjellin në formë të shkruar.

Ibrahim Makolli - Duke u ndërlidhur me grupi punues tha se ka bërë një punë të mirë për këtë projektligj, dhe se i ka plotësuar kushtet për të kaluar në lexim të parë; ka mundësi që të bëhet një ligj i mirë që e zgjidh deri diku problematikën për të cilën bëhet fjalë, jo krejt, sepse është e pamundur, duke parë hezitimin e të tjerëve që ky ligj të ndryshohet në pajtim me kërkesat tona që i kemi. Kam një përshtypje, që ndoshta më mirë është të mos kalojë si i tillë, se sa të kalojë kështu si është, sepse nuk parasheh, as nuk rregullon asgjë ma shumë se sa ato që janë në rregullore.

Mbledhja përfundoi në orën 13. 40

Kryetari i Komisionit

Fatmir Rexhepi